



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Primjeño / Prodato<br>Received / Delivery | 23.09.2022                    | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ / Njesia<br>Org. / Jedinica<br>Org. / Unit                | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKPMSICK  | 5652/2022                     |                               | 1/5                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.699/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.699/2022 të datës 11.08.2022, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Komunës së Deçanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. *Aprovohet* ankesa me numër A.nr.699/2022 e datës 11.08.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

III. *Anulohet* procedura ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00009152 për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave", e shpallur me datë 03.06.2022 nga Komuna e Deçanit si dhe çdo veprim që rrjedhë nga kjo procedurë praniami.

IV. *Obligohet* Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Deçanit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën I të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 11.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4664/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, lidhur me konkursin \_\_\_\_\_

ngritje në detyrë për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa me pretendimin së Komuna e Deçanit ka ndryshuar kriteret e konkursit me ëellim që ato ti përshtaten kandidatës së përzgjedhur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Deçanit, ndërsa kjo e fundit më datë 23.08.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4664/2022 të datës 11.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin Nr.02/Zyrtarisht të datës 14.07.2022 të Njësisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 06.07.2022 për përfshirjen në listën e ngushtë; Konkursin me numër reference RN00009152 të datës 03.06.2022; Konkursin me numër reference RN00008512 të datës 28.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4745/2022 të datës 15.08.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4919/2022 të datës 23.08.2022; Zarin e datës 16.08.2022; Shkresën lidhur sistemin informative për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me konkursin e datës 18.03.2022; Njoftimin me Nr.02/ Zyrtarisht të datës 06.04.2022; Vlerësimi i aplikanteve në sistemin informativ me numër reference RN00009152; Emalin e datës 21.07.2022; Vendimin me Nr.02/zyrtarisht të datës 14.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Deçanit; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 12.08.2022; Njoftimin e datës 12.08.2022 për përfundimin e procesit të vlerësimit, për ngritje /Avancim në detyrë në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa"; Njoftimin me e datës 06.07.2022 për përfshirjen në listën e ngushtë; Konkursin me numër reference RN00009152 e datës 03.06.2022 të shpallur në Sistemin Informativ të Burimeve Njerëzore; Konkursin me numër RN.00008512 të datës 28.02.2022; Akt emërimit me numër 02/20305 të datës 02.09.2015; Diplomën universitare me Nr.4249 të datës 15.04.2014 të ankuesit; Akt Emërimit me numër 12928 të datës 02.06.2018; Diplomën universitare me Nr.788 të datës 03.11.2020; Diplomën universitare me Nr.38/18 të datës 04.11.2019; Emalin e datës 12.09.2022 të I.Kukleci drejtuar Këshillit të Pavarur; Emalin e datës 12.09.2022 të Këshillit të avancuar drejtuar I.Kukleci; Emalin e datës 09.09.2022 të Këshillit të Pavarur drejtuar Aktin përcjellës me Nr.02/zyrtarisht të datës 12.09.2022; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar nga Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Dosjen e kandidatës së përzgjedhur; Aplikacionin e datës 27.06.2022 Dokumentin e identifikimit; Certifikatën me Nr.09/2022 të datës 11.02.2022 lidhur me përfundimin e trajnimit Moduli i Shpenzimeve; Formularin e vlerësimit në punë të datës 27.01.2022 të nëpunësve dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesëm i ulët dhe profesional;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së Komuna e Deçanit me datë 28.02.2022 ka shpallur Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008512 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave" nivel drejtues i ulët 2, e cila procedurë pranimi

është përfunduar sipas Njoftimit të datës 06.04.2022 të Zyrës së Personelit të Komunës së Deçanit me arsyetimin se nuk ka aplikuar asnjë kandidatë. Ndërsa me datë 03.06.2022 Komuna e Deçanit për pozita të njëjtë ka shpallur Konkursin ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00009152, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Në fazën e verifikimit paraprak, ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë pasi që sipas njoftimit të datës 06.07.2022 i njëjti nuk ka plotësuar kushtet e konkursit. Pas këtij njoftimi, ankuesi parashtron ankesë pranë Njesisë së Personelit të Komunës së Deçanit, ndërsa kjo e fundit me Vendimin Nr.02 të datës 14.07.2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit po me bazë të njëjta refuzimi.

Me tej, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton së Komuna e Deçanit ka shpallur si kandidat të suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave", me gjithsej 75.33 pikë.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e aplikueshme lidhur me ngritjen në detyrë të nëpunësve civil përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L114 për Zyrtarët Publikë, Nenin 39 me të cilin është përcaktuar se: "1.Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3. Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë. 4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, për procedurën e ngritjes në detyrë zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 deri 9 të nenit 34 të këtij ligji....".

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 40 me të cilin është përcaktuar se: "...2. Lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për secilën pozitë të lirë. 3. Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil..., nenin 41 ku parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2.Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë", Neni 52 me të cilin theksohet se : "Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë. 2.Ngritja në detyrë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për një pozitë të lirë. 3.Konkurimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të

shërbimit civil dhe nenin 53 me të cilin asht përcaktuar se: " 1. Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e përvojës në punë; 2.2. nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nënparagrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende; 2.3. nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mire" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë. 3.Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale "shumë mirë" apo shkëlqyeshëm për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët. 4.Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë.

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht, Neni 4 përcakton se: "1.Në pajtim me Ligjin, pozitat e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale, Neni 12 parasheh se: Klasat përbërëse të kategorisë së Ulët Drejtuese, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë:" ....Drejtues i Ulët 2 1. Udhëheqës i Divizionit në një Agjenci Ekzekutive; 2. Udhëheqës i Sektorit në një Komunë.

Andaj, në vështrim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Konkursit për ngritje në detyrë me numër reference RN00009152, për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave", si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimi: Diplomë/a e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Përvoja e punës: Së paku shtatë (5) vite përvojë pune profesionale,** rrjedhimisht Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur së kandidatja e zgjedhur lidhur me fushën e arsimit posedon Diplomë me Nr.38/18 të lëshuar nga Kolegji "Dukagjini", më të cilën dëshkohet së e njëjta ka përfunduar studimet themelore në programin Banka, Financa dhe Kontabilitet më datë 16.07.2018, kurse sipas diplomës me nr.778 të lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" ka përfunduar studimet master duke marr titullin Master i Arteve në Kontabilitet dhe Financa, ndërsa lidhur me përvojën e punës kandidatja e përzgjedhur posedon Akt Emërimit më numër protokolli 20305 të datës 02.09.2015 lidhur me emërimin Asistente Administrative në Zyrën e Tatimit në Pronë në Komunën e Deçanit, si dhe Akt Emërimit me numër protokolli 12928 të datës 02.06.2018 lidhur me emërimin Zyrtar i Depos 3 në Komunën e Deçanit, andaj nisur nga këto fakte rrjedh së kandidatja e zgjedhur nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës respektivisht e njëjta nuk ka pesë (5) vite përvojë të punës profesionale, kështu që duke u bazuar edhe në konstatimet sipas Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.201 dhe A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, përvojë e punës profesionale njihet vetëm periudha pas diplomimit, përkatësisht ankuesja ka diplomuar me datë 16.07.2018, duke nënkuptuara së e njëjta deri në ditën e aplikimit me datë 26.07.2022 nuk ka pesë (5) vite përvojë profesionale të punës, andaj mbi këtë bazë rezulton së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji i Këshillit bazuar në shqyrtimin e provave materiale ka konstatuar së organi i punësimit në këtë rast Komuna e Deçanit, me rastin e përcaktimit të kushteve të përgjithshme formale ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sepse tek kriteri i arsimit nuk ka specifikuar fushën e arsimit për pozitën e shpallur dhe së më rastin e mos përfshirjes së ankuesit në listën e ngushtë nuk ka nxjerr vendim siç përcaktohet me nenin 57 lidhur me nenin 45 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se " ...5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve".

Nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së Konkursi ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00009152 për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave*, është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dh 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një procedurë pranimi e përfshirë më shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, andaj me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë Kolegji i Këshillit në mbështetje të Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda: A.nr.699/2022


Ilire Mehmeti -SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Deçanit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit